



SOS FSHATRAT E
FËMIJËVE
KOSOVË



SOS FSHATRAT E
FËMIJËVE
KOSOVË

Nr. i protokollit: 432

Data: 17.11.2020

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN



Pranuar më:	26.11.2020	
Prilijeno:	26.11.2020	
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtesca Dodatak
1-560-	52929	

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

FONDACIONI SOS FSHATRAT E FËMIJËVE KOSOVË me numër të regjistrimit
5200200-1 dhe adresë në Rr. 1 Tetori p.n. Velania, 10000, Prishtinë, Kosovë

dhe

Qendra për Punë Sociale Lipjan në Rr. Avdi Kelmendi, Lipjan, Kosovë

lidhin këtë

Marrëveshje bashkëpunimi

Duke pasur parasysh misionin dhe qëllimin e Fondacionit SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, për mbështetjen dhe fuqizimin e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe fëmijëve në rrezik të humbjes së përkujdesjes prindërore, njëra nga komponentët kyçe të zbatimit të projektit "Rrugëtim i Sigurtë drejt të Ardhmes" të mbështetur teknikisht dhe financiarisht nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë, ka për qëllim mbështetjen e Qendrës për Punë Sociale në ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje në rrezik e në veçanti azilkërkuesit, refugjatët dhe migrantët në tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohen gjatë qëndrimit në Kosovë.

Me qëllim të mbështetjes dhe fuqizimit të fëmijëve dhe familjeve në gjendje të vështirë psiko-sociale dhe ekonomike, përfshirë këtu edhe azilkërkuesit, refugjatët dhe migrantët, palët e lartëpërmendura pajtohen si në vijim:

I. Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është zyrtarizimi i bashkëpunimit të palëve, për të arritur bashkarisht përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve në Komunën e Lipjanit përmes këtyre aktiviteteve:

1. Bashkëpunimi në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme në përkrahje të Qendrës për Punë Sociale Lipjan,
2. Vlerësimi i nevojave të fëmijës dhe familjeve dhe përcaktimi i mënyrave të intervenimit dhe shërbimeve që do të ofrohen fëmijëve, të rinjve dhe familjes,
3. Punë këshillëdhënëse me familjet dhe fëmijët në fushën e mirëqenies sociale dhe kujdesit për fëmijë,



4. Ndhimë dhe trajnim i prindërve për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve,
5. Hartimi i planeve individuale të zhvillimit dhe punë me fëmijët dhe familjet bazuar në ato plane,
6. Organizimi dhe lehtësimi i aktiviteteve rekreative dhe edukative për fëmijë, të rinjë dhe familje,
7. Kontakte me shkolla dhe institucione tjera që u ofrojnë shërbime fëmijëve dhe familjeve migrant dhe azilkërkues,
8. Identifikimi i burimeve të mundshme të ndihmës nga komuniteti,

II. Obligimet dhe përgjegjësitë e Fondacionit SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Obligimet dhe përgjegjësitë e Fondacionit SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë janë si në vijim:

1. Do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në nenin I.1) të Marrëveshjes,
2. Ofrimin e përkrahjes profesionale dhe shkëmbimin e informatave për fushën e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve të marginalizuar, menaxhimin e rasteve, teknikat e punës me fëmijë dhe familje,
3. Do të monitorojë dhe vlerësojë procesin e përfituesve duke përfshirë identifikimin e rasteve, referimin dhe intervenimin,
4. Të raportoj për njëdhën e punës si dhe të bashkëveproj me të gjithë akterët relevant lokal.

III. Obligimet dhe përgjegjësitë e Qendrave për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit

Obligimet dhe përgjegjësitë e Qendrave për Punë Sociale në Lipjan janë si në vijim:

1. Mbështetë Fondacionin SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë përkatësisht Punëtorin Social të angazhuar nga Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në identifikimin, referimin si dhe trajtimin e përfituesve,
2. Do të asistojë Fondacionin SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë në organizimin e aktiviteteve për përfituesit të identifikuar në nenin I.1) të Marrëveshjes,
3. Referimi i rasteve bazuar në kriteret e parapërcaktuara me të cilët do të zhvillohen aktivitetet nga neni I.1) e Marrëveshjes,

IV. Përfundimet


1. Asgjë në këtë marrëveshje nuk nënkupton një obligim të fondacionit SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë për përkrahje direkte financiare për përfituesit apo Qendrën për Punë Sociale në Lipjan, përpos shpenzimeve që i mbulon Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve në kryerjen e aktiviteteve nga neni I,1 i Marrëveshjes.
2. Raporti i palëve është raport i vullnetit të mirë për bashkëpunim në arritjen e synimeve të përcaktuara me Marrëveshje ndaj edhe mosrespektimi i të njejtës nga cilado palë nuk tërheq pasoja ligjore, me përjashtim të ndonjë dëmi të qëllimshëm

që mund t'i shkaktohet njërës apo tjetrës palë në procesin e bashkëpunimit, me ç'rast zbatohen dispozitat e përgjithshme mbi shkaktimin e dëmit.

V. Dispozitat kalimtare


1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data: **08.10.2020**
2. Kjo marrëveshje mund të shkëputet me marrëveshje nga të dyja palët, apo me kërkesë të njërës palë, me zotim të secilës palë për njoftim për zgjedhje të Marrëveshjes, me shkrim dhe në afat paraprak prej 30 ditësh.
3. Kjo marrëveshje përgatitet në dy versione origjinale, nga një për secilën prej palëve .

Për Komunën e Lipjanit


Z. Imri Ahmeti
Kryetari i Lipjanit



Për Fondacionin SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë


Znj. Nezahat Salihu
Drejtore Nacional

